

KONTRATE PER SHITJE KUOTA

Sot me 05/09/2019, ne Tirane, prane zyres se shoqerise "SuperBeton Mati" Shpk, u perpilua kontrata e shitjes se kuotave midis paleve si me poshte:

Shitesi, eshte ortak i Shoqerise "**SuperBeton Mati**" Shpk, me seli ne Diber, KLOS Bulevardi Rexhep Pashe Mati, Pallati 1, Shkalla 1, Apartamenti 4, Kati 2, regjistruar me numer tatimor J6902908A , themeluar me 15/05/1993, perkatesisht:

1. **Shitesi ortak i vetem i shoqerise "SuperBeton Mati" Shpk, z.Gani Hoxha**, i biri Selman, i datëlindjes 29.05.1963, lindur në Guri i Bardhe/Mat, dhe banues në Rr. Karl Gega, Pll 3/1, Shkalla, Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar nëpërmjet leternjofimit me **nr. G30529005C**,

me poshte te quajtur ne kete kontrate si "**Shitesi**"

dhe,

2. **Bleresi, shoqeria "SBM 93 Holdings Ltd"**, me regjistrim te kompanise me **nr. 11894649**, me seli ne adresen **68 Victory Parade, London, United Kingdom, Post Code: SE18 6FW**, me administrator z. Gani Hoxha i datëlindjes 29.05.1963, lindur në Guri i Bardhe/Mat i identifikuar nëpërmjet leternjofimit me **nr. G30529005C**,

me poshte i quajtur ne kete kontrate si "**Bleresi**"

Ketu e tutje te quajtura palet:

Duke marre ne konsiderate se shitesi ka ne pronesi te tij pjese te zoteruara **100% (Njeqind %)** te kuotave te shoqerise "**SuperBeton Mati**" Shpk, sipas ekstraktit te nxjerre nga Qendra Kombetare e Bisnesit, **si dhe duke marre ne konsiderate dhe mbledhjen e Asamblese se ortakeve** te Shoqerise shitese, te dates 04/09/2019 me nr. 03 vendimi, ku me ane te Vendimi te saj kane dhene miratimin per transferimin e se drejtes se pronesise se **100%** te kuotave tek "**Bleresi** ", **ne masen 100%**.

Palet ne kete kontrate rane dakort persa me poshte vijon:

1. Shitesi , shet tek **bleresi** te drejten e pronesise te kuotave te kapitalit themeltar,te shoqerise, "**SuperBeton Mati**" Shpk ne masen 100%.
2. **Bleresi** i aksioneve ka rene dakort te marre te drejtat e pronesise mbi keto aksione, duke paguar per kete transferte shumen e pasqyruar ne kete kontrate shitje.
3. Cmimi total i Shitjes per **Bleresin** per aksionet ne masen **100%** jane **120 leke** (Njeqind e njezet leke).
4. Ne ditën e nenshkrimit te kesaj kontrate , shitesi garanton Bleresin se kuotat e kesaj kontrate jane ne pronesi te tyre,dhe se asnje i trete nuk ka pretendime pronesie mbi to, ne ditën e nenshkrimit te kesaj kontrate, dhe se deri ne kete date shitesi nuk ka nenshkruar asnje kontrate tjeter per tjetersimin e ketyre kuotave nga ndonje pale e trete.
5. Bleresi ka paguar shumen e specifikuar ne piken 4 qe me nenshkrimin e kesaj kontrate. Shitesi pranon se i ka marre keto leke para se kjo kontrate te firmoset.

6. Me permbushjen e pikave te kesaj kontrate do te behen ndryshimet e nevojshme ne "QKB" (Qendra Kombetare e Regjistrimit).
7. Te gjitha te drejtat dhe detyrimet te cilat jane te lidhura me pronesine mbi kuotat e parashikuara ne kete kontrate, do te rregjistrohen ne favor te **Bleresit**.
8. Shitesi garanton Bleresin, se ne ditën e nenshkrimit te kesaj kontrate, kuotat qe ai do te shese nuk do jene te lena peng, apo ne ndonje forme tjeter sigurimi per permbushjen e detyrimeve per pale te treta, dhe se keto kuota nuk do te perfshihen ne ndonje proces falimentimi apo likuidimi.
9. Per cdo gje qe nuk eshte e parashikuar ne kete kontrate do te zbatohen dispozitat e Kodit Civil ,dhe ne menyre te vecante nenet 705 e vijues te ketij kodi.
10. Per cdo mosmarveshje qe mund te lindin mes paleve , ato mund ti zgjidhin me mirekuptim mes tyre ,ose ne rast te kundert do ti drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
11. Shitesi eshte pergjegjes per te gjitha detyrimet fiskale qe mund te perbehen nga tatime e taksa, ne lidhje me pagimin e cmimit per blerjen e kuotave dhe qe jane ne fuqi ne momentin e kryerjes se pageses.
12. Kjo kontrate u hartua ne 6 kopje te njejta ,nga nje per secilen pale, dhe kopjet e tjera per te kryer veprimet ligjore proceduriale, per miratimin nga autoriteti i mbikqyrjes Financiare dhe per regjistrim prane QKB te Shqiperise dhe te regjistrimit te kuotave.

Kjo kontrate pasi ju lexua me ze te larte paleve , u nenshkrua prej tyre me vullnetin e tyre te lire e te plote.

PALET

SHITESI

Ortaku i Vetem i "SuperBeton Mati" Shpk

GANI HOXHA



BLERESI

"SBM 93 HOLDINGS" LTD
Administrator
GANI HOXHA

